



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Legjislacion

Mbledhja nr. 16

Prishtinë, më 20 korrik 2011, në orën 9:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për Legjislacion

Në mbledhje morën pjesë: Arben Gashi – kryetar, Ardian Gjini Mufera Šinik, Arsim Bajram, Halit Krasniqi, Haki Demolli, Albulena Haxhiu, Armend Zemaj dhe Jasmina Zhivkoviq.

Munguan: Behar Selimi dhe Ibrahim Makolli.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Nezir Kuçi- përkthyes, Lumnije Murati – ZPRK, Albert Avdiu – Këshilli Gjyqësor, Mertita Stublla Emini- USAID, Natyra Kasumaj – KDI, Lejla Selimi – OSBE, Artan Canhasi – EULEX, Valbona Puka - AP dhe Fixhrije Dragaj-praktikante.

Nga Stafi i Komisionit për Legjislacion: Idriz Tahiri dhe Visar Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi: Arben Gashi, kryetar i Komisionit.

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 22.06. 2011,
3. Shqyrtimi i Projektligjit për mbrojtjen e dëshmitarëve me amendamentet e propozuara nga grupi punës,
4. Shqyrtimi i projektligjit për ndihmë juridike falas me amendamentet e propozuara nga grupi punës,
5. Shqyrtimi i projektligjit për nisma legislative,
6. Shqyrtimi i përfundimit të Kryesisë nr. 04-P-039/k i datës 5 korrik 2011,
7. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr.04/L-28 për Dizajnin industrial,
8. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin për Përdorim Civil të Eksplozivëve Nr.04/L-22,
9. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr.04/L-26 për Markat Tregtare,
10. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 04/L-014 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim,
11. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr.04/L-29 për Patenta,

12. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin për Kadastër nr. 04/249/L-013,
13. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-8 për Verërat nr.04/375/L-019,
14. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin për Ndhmën Shtetërore nr. 04 / L -024,
15. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L-001 për përfitimin e ish zyrtarëve të lartë,
16. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për mbrojtjen e informatorëve,
17. Shqyrtimi i shkresës së Këshillit Gjyqësor të Kosovës për emërimin e anëtarëve të Këshillit,
18. Të ndryshme

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 22. 6. 2011

Kryetari konstatoi se Komisioni e miratoi procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 22. 6. 2011, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për mbrojtjen e dëshmitarëve me amendamentet e propozuara nga grupi punës

Kryetari – kërkoi nga Armend Zemaj si kryesues i grupit të punës të paraqesë arsyetimin për amendamentet e propozuara.

Armend Zemaj – në cilësi të kryesuesit të grupit punues e njoftoi Komisionin se grupi punues ka paraqitur 19 amendamente në P/L për mbrojtjen e dëshmitarëve. Ai dha sqarime për secilin amendament si dhe sqaroi se grupi punues ka marr parasysh propozimet e bëra nga EULEX-i dhe i ka inkorporuar në amendamentet e bëra nga grupi punues.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Legjislacion njëzëri nxori këtë:

Përfundim

I. Miratohet Raporti me amendamente i Komisionit për Legjislacion

II. I rekomandohet Kuvendit të Kosovës miratimi i Projektligjit për mbrojtjen e dëshmitarëve me amendamentet e propozuara.

III. Amendamentet e Miratuara janë paraqitur si aneks i këtij Procesverbali.

4. Shqyrtimi i projektligjit për ndihmë juridike falas me amendamentet e propozuara nga grupi punës

Kryetari i njoftoi se grupi punës ka paraqitur 8 amendamente në P/L për ndihmë juridike falas dhe kërkoi nga anëtarët që nëse kanë vërejtje ti paraqesin.

Meqë nuk kishte vërejtje, Kryetari konstatoi se Komisioni për Legjislacion njëzëri nxori këtë:

Përfundim

I. Miratohet Raporti me amendamente i Komisionit për Legjislacion

II. I rekomandohet Kuvendit të Kosovës miratimi i Projektligjit për ndihmë juridike falas me amendamentet e propozuara.

III. Amendamentet e Miratuara janë paraqitur si aneks i këtij Procesverbali.

5. Shqyrtimi i projektligjit për nisma legislative

Albulena Haxhiu propozoi që për shqyrtimin e këtij P/L të formohet një grup punues.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Legjislacion njëzëri nxori këtë:

Përfundim

Formohet Grupi i punës për shqyrtimin e Projektligjit për nismat legislative në këtë përbërje:

- Arsim Bajrami – (GP-PDK) kryesues
- Haki Demolli - (GP- LDK) - anëtar
- Albulena Haxhiu -(GP- VV) - anëtar
- Behar Selimi - (GP-PDK) - anëtar
- Jasmina Živković (GP- SLS) - anëtar

6. Shqyrtimi i përfundimit të Kryesisë nr. 04-P-039/k i datës 5 korrik 2011

U diskutua lidhur me përfundimin e Kryesisë me të cilin obligohet Komisioni që të filloj procedurat për zgjedhjen e drejtorit të agjencisë Kundër Korrupsionit. Për këtë pikë diskutuan, Arben Gashi, Arsim Bajrami, Ardian Gjini, Armend Zemaj, Albulena Haxhiu dhe Haki Demolli.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Legjislacion njëzëri nxori këtë:

Përfundim

Komisioni ngarkon zyrën e personelit ta zbatojë procedurën e konkursit për zgjedhjen e drejtorit të Agjencisë Kundër Korrupsionit, në pajtim me Ligjin për Agjencinë Kundër Korrupsionit.

7. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit Funksional në Projektligjin nr.04/L-28 për Dizajnin industrial,

U shqyrtua raporti me amendamente i Komisionit Funksional në Projektligjin nr.04/L-28 për Dizajnin industrial dhe nuk kishte vërejtje nga anëtarët e Komisionit.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Legjislacion njëzëri nxori këtë:

Përfundim

1. Projektligji nr. 04/L-28 për Dizajnin industrial e ka bazën juridike në nenin 65.1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.
2. Amendamentet e Komisionit Funksional e kanë bazën juridike në Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe nuk janë në mospajtim me ligjin e zbatueshëm në Kosovë.
3. Projektligji me amendamentet e propozuara nga Komisioni Funksional mund të procedohet për shqyrtim dhe për miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit.

8. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit Funksional në Projektligjin për Përdorim Civil të Eksplozivëve Nr.04/L-22

U shqyrtua raporti me amendamente i Komisionit Funksional në Projektligjin për Përdorim Civil të Eksplozivëve Nr.04/L-22 dhe nuk kishte vërejtje nga anëtarët e Komisionit.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Legjislacion njëzëri nxori këtë:

Përfundim

1. Projektligji për Përdorim Civil të Eksplozivëve Nr.04/L-22 e ka bazën juridike në nenin 65.1 të Kushtetutës të Republikës së Kosovës.
2. Amendamentet e Komisionit Funksional e kanë bazën juridike në Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe nuk janë në mospajtim me ligjin e zbatueshëm në Kosovë.
3. Projektligji me amendamentet e propozuara nga Komisioni Funksional mund të procedohet për shqyrtim dhe për miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit.

9. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit Funksional në Projektligjin nr. 04/L-26 për Markat Tregtare

U shqyrtua raporti me amendamente i Komisionit Funksional në Projektligjin nr. 04/L-26 për Markat Tregtare dhe nuk kishte vërejtje nga anëtarët e Komisionit.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Legjislacion njëzëri nxori këtë:

Përfundim

1. Projektligji nr. 04/L-26 për Markat Tregtare e ka bazën juridike në nenin 65.1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.
2. Amendamentet e Komisionit Funksional e kanë bazën juridike në Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe nuk janë në mospajtim me ligjin e zbatueshëm në Kosovë.
3. Projektligji me amendamentet e propozuara nga Komisioni Funksional mund të procedohet për shqyrtim dhe për miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit.

10. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit Funksional në Projektligjin nr. 04/L-014 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim

U shqyrtua raporti me amendamente i Komisionit Funksional në Projektligjin nr. 04/L-014 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim dhe nuk kishte vërejtje nga anëtarët e Komisionit

Kryetari konstatoi se Komisioni për Legjislacion njëzëri nxori këtë:

Përfundim

1. Projektligji nr. 04/L-014 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim e ka bazën juridike në nenin 65.1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.
2. Amendamentet e Komisionit Funksional e kanë bazën juridike në Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe nuk janë në mospajtim me ligjin e zbatueshëm në Kosovë.
3. Projektligji me amendamentet e propozuara nga Komisioni Funksional mund të procedohet për shqyrtim dhe për miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit.

11. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit Funksional në Projektligjin nr. 04/L-29 për Patenta

U shqyrtua raporti me amendamente i Komisionit Funksional në Projektligjin nr. 04/L-29 për Patenta dhe nuk kishte vërejtje nga anëtarët e Komisionit

Kryetari konstatoi se Komisioni për Legjislacion njëzëri nxori këtë:

Përfundim

1. Projektligji nr. 04/L-29 për Patenta e ka bazën juridike në nenin 65.1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

2. Amendamentet e Komisionit FunkSIONAL e kanë bazën juridike në Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe nuk janë në mospajtim me ligjin e zbatueshëm në Kosovë.
3. Projektligji me amendamentet e propozuara nga Komisioni FunkSIONAL mund të procedohet për shqyrtim dhe për miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit.

12. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin për Kadastër nr. 04/249/L-013

U shqyrtua raporti me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin për Kadastër dhe nuk kishte vërejtje nga anëtarët e Komisionit

Kryetari konstatoi se Komisioni për Legjislacion njëzëri nxori këtë:

Përfundim

1. Projektligji për Kadastër nr. 04/249/L-013 e ka bazën juridike në nenin 65.1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.
2. Amendamentet e Komisionit FunkSIONAL e kanë bazën juridike në Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe nuk janë në mospajtim me ligjin e zbatueshëm në Kosovë.
3. Projektligji me amendamentet e propozuara nga Komisioni FunkSIONAL mund të procedohet për shqyrtim dhe për miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit.

13. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-8 për Verërat nr.04/375/L-019

U shqyrtua raporti me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin për Verërat dhe nuk kishte vërejtje nga anëtarët e Komisionit

Kryetari konstatoi se Komisioni për Legjislacion njëzëri nxori këtë:

Përfundim

1. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-8 për Verërat nr.04/375/L-019, e ka bazën juridike në nenin 65.1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.
2. Amendamentet e Komisionit FunkSIONAL e kanë bazën juridike në Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe nuk janë në mospajtim me ligjin e zbatueshëm në Kosovë.
3. Projektligji me amendamentet e propozuara nga Komisioni FunkSIONAL mund të procedohet për shqyrtim dhe për miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit.

14. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin për Ndhmën Shtetërore nr. 04 / L -024

U shqyrtua raporti me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin për Ndhmën Shtetërore dhe nuk kishte vërejtje nga anëtarët e Komisionit

Kryetari konstatoi se Komisioni për Legjislacion njëzëri nxori këtë:

Përfundim

1. Projektligji për Ndhmën Shtetërore, e ka bazën juridike në nenin 65.1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.
2. Amendamentet e Komisionit FunkSIONAL e kanë bazën juridike në Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe nuk janë në mospajtim me ligjin e zbatueshëm në Kosovë.
3. Projektligji me amendamentet e propozuara nga Komisioni FunkSIONAL mund të procedohet për shqyrtim dhe për miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit.

15. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L-001 për përfitimin e ish zyrtarëve të lartë

Komisioni vlerësoi se Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L-001 për përfitimin e ish zyrtarëve të lartë, i plotëson kushtet e përcaktuara që të procedohet për shqyrtim dhe për miratim në parim.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Legjislacion njëzëri u pajtua që Kuvendit t'ia paraqesë këtë

R e k o m a n d i m

Të shqyrtohet dhe të miratohet, në parim, Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L-001 për përfitimin e ish - zyrtarëve të lartë.

16. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për mbrojtjen e informatorëve

Komisioni vlerësoi se Projektligji për mbrojtjen e informatorëve, i plotëson kushtet e përcaktuara që të procedohet për shqyrtim dhe për miratim në parim.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Legjislacion njëzëri u pajtua që Kuvendit t'ia paraqesë këtë

R e k o m a n d i m

Të shqyrtohet dhe të miratohet, në parim, Projektligji për mbrojtjen e informatorëve, nr. 04/L-43

17. Shqyrtimi i shkresës së Këshillit Gjyqësor të Kosovës për emërimin e anëtarëve të Këshillit

Arsim Bajrami, propozoj që kjo çështje të diskutohet në mbledhjen e radhës.

Komisioni u pajtua që shqyrtimi i shkresës së Këshillit Gjyqësor të Kosovës për emërimin e anëtarëve të Këshillit, të shtyhet për një mbledhje të radhës.

18. Të ndryshme

Albulena Haxhiu- Ngriti çështjen që ka të bëjë me vendimin e Qeveris për formimin e këshillit Konsultativ për Drejtësi, e që të gjitha vendimet e KGJK-së duhet të kalojë përmes këtij këshilli gjë që për mendimin tim kjo është kundër kushtetuese.

Mbledhja përfundoi në orën 11:50.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetar i Komisionit

Arben Gashi

Amendamentet në Projektligjin për mbrojtjen e dëshmitarëve

Amendamenti 1

Neni 1 riformulohet si vijon:

Qëllimi i ligjit

Me këtë ligj rregullohen masat e posaçme dhe urgjente, mënyrat dhe procedurat për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë.

Amendamenti 2

Shtohet neni i ri (neni 2) me përmbajtje, si vijon:

Neni 2

Fushëveprimi i Ligjit

Me këtë ligj ofrohet mbrojtje për dëshmitarët dhe bashkëpunëtorët e drejtësisë vetëm për llojet e veprave penale të parapara me paragrafin 1, të nenit 3 të këtij ligji.

Neni 2 i projektligjit bëhet neni 3 dhe nenet në vazhdim radhiten sipas numrave me radhë.

Amendamenti 3

Neni 2, paragrafi 1, pika 3 riformulohet si vijon:

1.3 “**Person i mbrojtur** – është personi, ndaj të cilit zbatohen masat e mbrojtjes dhe i cili, në cilësinë e dëshmitarit ose të personit të dëmtuar, bën njoftime ose dëshmon për fakte e rrethana, që përbëjnë objekt prove relevante në një procedurë penale, për vepra penale të parapara me paragrafin 1, të nenit 3 dhe që për shkak të këtyre njoftimeve ose dëshmive, ndodhet në gjendje të rrezikut serioz,

dhe personi, që vuan dënimin penal ose është i pandehur në një procedurë penal, ndaj të cilit zbatohen masa e posaçme të mbrojtjes, për shkak të bashkëpunimit, njoftimeve dhe deklarimeve të bëra në procedurën penale, për vepra penale të parapara me paragrafin 1, të nenit 3 dhe që për këto arsye, ndodhet në gjendje të rrezikut serioz.

Amendamenti 4

Neni 3, paragrafi 1 riformulohet si vijon:

1. Masat e mbrojtjes mund të zbatohen para, gjatë dhe pas procedurës penale për personin e rrezikuar në lidhje me hetimet për veprat penale në vijim:

1.1 Vepër penale kundër Kosovës, shtetasve dhe banorëve të saj;

1.2 Vepër penale kundër të drejtës ndërkombëtare;

1.3 Vepër penale kundër ekonomisë;

1.4 Vepër penale kundër detyrës zyrtare;

1.5 Vepër penale për të cilën me ligj parashihet dënimi me pesë ose më shumë vite burgim.

Amendamenti 5

Neni 4, në fund të paragrafit 3 shtohet fjalia me përmbajtje si vijon:

“përveç rastit të paraparë me paragrafin 4 të këtij neni”.

Amendamenti 6

Neni 4, paragrafi 4 i riformulohet si vijon:

4. Nëse ekziston baza mbi të cilën mund të vendoset për masat mbrojtëse, por personi i rrezikuar nuk është në gjendje të japë pëlqimin e tij për shkak të gjendjes fizike ose mendore të tij, masat mbrojtëse urdhërohen dhe zbatohen deri në ndryshimin e rrethanave kur personi i mbrojtur do të jetë në gjendje të japë pëlqimin e tij për t’u mbrojtur, ***me përjashtim të masës së paraparë me paragrafin 2.6 të këtij neni***. Nëse personi i mbrojtur refuzon të japë pëlqimin, mbrojtja e caktuar ndërpritet.

Amendamenti 7

Neni 16, paragrafi 1 riformulohet si vijon:

1. Drejtoria për mbrojtjen e dëshmitareve është njësi organizative e specializuar nën vartësi të drejtpërdrejtë të drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Kosovës, misioni i së cilës është zbatimi i masave të mbrojtjes së dëshmitarëve.

Amendamenti 8

Neni 16, shtohet paragraf 3 me përmbajtje si vijon:

3. Drejtoria ka fondin e veçantë financiar, të cilin e menaxhon drejtori i Drejtorisë për Mbrojtje të Dëshmitareve, sipas udhëzimit të veçantë të miratuar nga ministri i Punëve të Brendshme dhe ministri i Financave.

Paragrafi 3 i projektligjit bëhet paragrafi 4.

Amendamenti 9

Në nenin 18 fjala “***duhet***” zëvendësohet me fjalën “***obligohen të***”.

Amendamenti 10

Neni 19, paragrafi 4 riformulohet si vijon:

Kryeprokurori i Shtetit brenda 24 orëve pas pranimit të kërkesës do t'ia përcjellë të gjitha informatat e pranuar Drejtorisë që t'i mundësojë përgatitjen e mendimit dhe vlerësimit të shkallës së rrezikut të personit të propozuar për përfshirje në program ose të personit të afërm të tij dhe përshtatshmërinë e tyre për përfshirje në program dhe të ndërmarrin masa urgjente nëse është e nevojshme.

Amendamenti 11

Neni 19, shtohet paragraf i ri me përmbajtje si vijon: “ 5. Kur një kërkesë pranohet nga personi i rrezikuar në përputhje me paragrafin 3 të këtij neni, kryeprokurori i Shtetit do të ndërmarrë veprimet e menjëhershme brenda 24 orëve lidhur me kërkesën. Kur sigurohet që të gjitha informacionet relevante janë në dispozicion, kryeprokurori i Shtetit do t'ia përcjellë Drejtorisë të gjitha informatat e pranuar brenda 24 orëve.

Paragrafi 5 bëhet paragrafi 6.

Amendamenti 12

Neni 22, paragrafi 1, numri “ 30 “ zëvendësohet me “ 15 “.

Amendamenti 13

Neni 22, në fund të paragrafit 3 shtohet fjalia me përmbajtje si vijon:

“ përveç rastit të paraparë me paragrafin 4, të nenit 4 të këtij ligji”.

Amendamenti 14

Neni 23, paragrafi 1 riformulohet si vijon:

1. Në raste specifike dhe urgjente, pas kërkesës së prokurorit kompetent ose gjykatësit të rastit penal, brenda 24 orëve drejtori i Drejtorisë mund të marrë vendim për zbatimin e programit të masave urgjente të mbrojtjes. Për zbatimin e masave urgjente, duhet të lidhet marrëveshje e përkohshme e mbrojtjes në mes të drejtorit dhe personit të mbrojtur, përveç rastit të paraparë me paragrafin 4 të nenit 4 të këtij ligji.

Amendamenti 15

Neni 23, shtohen paragrafët 2 dhe 3 me përmbajtje si vijon:

2. Komisioni duhet të vendosë brenda 30 ditëve nga dita e fillimit të zbatimit të programit të masave urgjente të mbrojtjes për përfshirje të personit të mbrojtur në Programin e Mbrojtjes së dëshmitarëve.

3. Masat urgjente vazhdojnë deri në vendimin e Komisionit për mbrojtjen e dëshmitareve.

Paragrafët: 2, 3 dhe 4 të projektligjit bëhen paragrafët: 4, 5 dhe 6.

Amendamenti 16

Neni 23, në fund të paragrafit 2 shtohet fjalia me përmbajtje si vijon:

“përveç rastit të paraparë me paragrafin 4, të nenit 4 të këtij ligji”

Amendamenti 17

Neni 26, paragrafi 1, nënparagrafi 1.3 riformulohet si vijon:

1.3. Kur personi i mbrojtur shkel në mënyrë serioze marrëveshjen e mbrojtjes, e cila mund ta dërgojë në rrezik serioz, marrëveshja për mbrojtje pushon me një njoftim me shkrim nga drejtoria pas marrjes së pëlqimit nga komisioni;

Amendamenti 18

Neni 27, paragrafi 3, fjala “**vendimit**” zëvendësohet me fjalën “**vlerësimit**”.

Amendamenti 19

Shtohet neni 30 me përmbajtje si vijon:

Neni 30 Dispozita ndëshkuese

Kushdo që e mashtron dhe e vë në lajthim Komisionin dhe Drejtorinë përmes paraqitjes së provave dhe fakteve të pavërteta për të përfutur një masë mbrojtjes sipas dispozitave të këtij Ligji dënohet në përputhje me dispozitat e Kodit Penal të Kosovës.

Neni 30 i Projektligjit radhitet sipas numrave me radhë

Amendamentet në Projektligjin për ndihmë juridike falas

Amendamenti 1

Neni 4 hiqet.

Nenet në vazhdim radhiten sipas numrave me radhë.

Amendamenti 2

Në kreun II shtohet titulli me këtë përmbajtje:

„DISPOZITAT THEMELORE”

dhe teksti vazhdon si në Projektligj.

Neni 5 hiqet, dhe radhitja e neneve në vazhdim bëhet sipas numrave me radhë.

Amendamenti 3

Neni 6 riformulohet si në vijim:

Neni 6

Shtrirja dhe llojet e ndihmës juridike falas

1. Ndihma juridike falas ofrohet në të gjithë territorin e Republikës së Kosovës.
2. Ndihma juridike falas ofrohet në procedurën civile, penale, administrative dhe kundërvajtëse.
3. Ndihma juridike falas jepet për këto lloje:
 - 3.1. informatat dhe këshillat juridike lidhur me procedurat ligjore;
 - 3.2. përpilimin e shkresave dhe tërë asistencën tjetër teknike, që ka të bëjë me kompletimin e lëndës dhe
 - 3.3. përfaqësimin në procedurën civile, penale, administrative dhe kundërvajtëse.

Amendamenti 4

Neni 13, paragrafi 4, fjalia **“të paragrafit 2 të këtij neni”**, të zëvendësohet me fjalinë **“të paragrafit 3 të këtij neni”**.

Amendamenti 5

Neni 15, paragrafi 3, riformulohet si në vijim:

Këshilli themelon, me vendim, Komisionin për Ankesa, që vendos në shkallë të dytë për ankesat e ushtruara ndaj vendimeve të nxjerra nga zyrrat rajonale.

Amendamenti 6

Neni 17, paragrafi 2, riformulohet si në vijim:

2. Kryesuesi i Këshillit zgjidhet nga përbërja e Këshillit për një mandat një vit e gjysmë pa të drejtë rizgjedhjeje.

Shtohet paragrafi 3 me përmbajtje si në vijim:

3. Kryesuesi i Këshillit përfaqëson Këshillin, thërret dhe udhëheq mbledhjet e këshillit dhe kryen përgjegjësi të tjera të përcaktuar me këtë ligj dhe me Rregulloren e punës që e nxjerr Këshilli.

Paragrafi 3 i Projektligjit bëhet paragrafi 4

Amendamenti 7

Neni 29 riformulohet si në vijim:

Zyrat rajonale janë organe që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në të gjithë territorin e Republikës së Kosovës, ashtu siç është përcaktuar në neni 24 të këtij ligji.

Amendamenti 8

Shtohet neni 35 me përmbajtje si vijim:

Neni 35 Aplikimi subsidiar

Në qoftë se me këtë ligj nuk është rregulluar në tërësi procedura e vendosjes sipas kërkesës për lejimin e ndihmës juridike falas, aplikohen dispozitat e ligjit të procedurës administrative.

Neni 35 bëhet neni 36 dhe nenet në vazhdim radhiten sipas numrave me radhë.